

THIRRJE PËR APLIKIME

Investime për diversifikimin e të ardhurave rurale dhe krijimi i vlerës së shtuar në zinxhirin e vlerës për produktet bujqësore lokale

Financuar nga projekti

UNJP/ALB/017/UNJP

“Forcimi i kapaciteteve të fermerëve, grave rurale, të rinjve dhe shërbimit këshillimor”

FAO - Organizata e Kombeve të Bashkuara për Bujqësinë dhe Ushqimin zhvilloi takimin informues të fermerëve dhe prodhuesve të vegjël në Hot për thirrjen për aplikime në kuadër të projektit.



Projekti është i financuar nga fondi i përbashkët i kombeve të bashkuara me qeverinë Shqiptare në kuadër të objektivave për zhvillim të qëndrueshëm (SDG) dhe zbatuar nga FAO synon të mbështesë fermerët dhe prodhuesit e vegjël përmes promovimit të praktikave më të mira ndërkombëtare në diversifikimin e të ardhurave rurale, krijimin e vlerës së shtuar në zinxhirin

ushqimor, bashkëpunimit të fermerëve për rritjen e standardeve të sigurisë ushqimore dhe promovimin e produkteve lokale.

Grupet e fermerëve nga komunitetet Hot, dhe fshatrat përreth, janë të pranueshëm për këtë thirrje për aplikim, në masën **“Investime për rritjen e vlerës së produkteve lokale bujqësore”** e cila synon të mundësojë grante për investime në vlerë të vogël. **Çdo grant i dhënë në këtë thirrje nuk mund të kalojë vlerën e 20,000 USD.** Në këtë shumë nuk përfshihet bashkëfinancimi i grupit të fermerëve.

“Thirrja për aplikime inkurajon bashkëpunimin midis fermerëve dhe përpunuesve të vegjël, dhe në investimet në agroturizëm, duke nxitur aplikantët që të përfitojnë nga investimet në grup, jo vetëm në nivel individual”, u shpreh në takim Agim Pepkolaj, drejtues i projektit të FAO-s.

Aplikimet duhen të plotësohen në mënyrë elektronike, forma e të cilës pranohet në gjuhën Shqipe ose Angleze, dhe rekomandohet të dërgohen dorazi në zyrën e FAO Shqipëri, në adresën: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Blv. Dëshmorët e Kombit, Nr. 2 Tiranë, PB 1001, Shqipëri.

Afati i fundit për pranimin e aplikimeve **është 5 Prill 2021.**